



NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.

Part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

NJOFTIM PUNE

Balfin Group është një ndër grupet private investuese më të mëdha në Shqipëri dhe rajon, i pranishëm me aktivitetet për zhvillimin e pasurive të paluajtshme, shitjet me pakicë, ofrimin e shërbimeve dhe menaxhimin e hapësirave tregtare apo industriale, telekomunikacion, industria minerare, financime dhe programe besimi për konsumatorët.

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C është pjesë e Balfin Group dhe operon në sektorin e Industrisë së Minierave.

Pozicioni: Zyrtar Senior për Financa dhe Tatime
Departamenti: Financa
Lokacioni: Drenas, Kosovë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mbështet procesin e mbylljes së muajit dhe fundvitit
- Verifikon, alokon, poston dhe barazon llogaritë e librit kryesor për të siguruar raportim të saktë dhe mirëmbajtje të librit kryesor
- Analizon informacione financiare
- Siguron mbështetje teknike për supervisorët
- Rishikon dhe rekomandon modifikime në sistemet dhe procedurat e kontabilitetit
- Merr pjesë në rishikimet e procedurave financiare
- Ndihmon me kontrollet tatimore dhe përgatit deklaratat tatimore
- Përgatit dokumentacionin për Auditorët e Jashtëm dhe të Brendshëm
- Asiston Shefin e Kontabilitetit dhe Menaxherin Financiar për të përmirësuar procedurat financiare
- Detyra të tjera të kërkuara nga Shefi i Kontabilitetit dhe Menaxheri Financiar

Kualifikimet dhe Aftësitë:

- Diplomë Universitare Bachelor në Fakultetin Ekonomik e detyrueshme, i preferueshëm Niveli Master
- Certifikatë "Teknik i Kontabilitetit" në SCAAK i detyrueshëm, "Kontabilist i çertifikuar" në SCAAK – e preferueshme
- Përvojë pune 3-5 vite
- Njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze (në të shkruar dhe në të folur – obligative)
- Njohuri të mira të legjislacionit vendor
- Njohuri të mira të SNRF-ve
- Aftësi kompjuterike të shkëlqyeshme (Microsoft Office)
- Njohuri të sistemit Microsoft Dynamics NAV – e preferueshme
- Shkathtësi të mira matematikore dhe analitike
- Shkathtësi të shkëlqyera komunikimi me gojë dhe me shkrim
- Te jetë interaktiv dhe bashkëpunues me të tjerët





NEWCO FERRONIKELI COMPLEX L.L.C.

Part of BALFIN, Balkan Finance Investment Group

Kushtet e punës:

NewCo Ferronikeli Complex L.L.C ofron paketë të mirë kompesimi dhe benefitesh, përfshirë edhe bonuse bazuar në meritë dhe vlerësimin e performancës.

Mënyra e aplikimit:

Kandidatët e interesuar janë të lutur të dërgojnë CV-të e tyre së bashku me letër motivimi dhe dokumentet përcjellëse më së largu deri më 30/10/2020, në adresën e e-mailit hr@ferronikeli.com duke përcaktuar në subjekt pozicionin "**Zyrtar Senior për Financa dhe Tatime**".

*Të gjitha aplikimet do të trajtohen me konfidencialitet të plotë dhe vetëm kandidatët që do të përzgjedhen në listen e ngushtë do të kontaktohen.

